



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Selmans Network shpk" të datës 29.12.2025 kundër njoftimit të AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e mobilerisë urbane" me nr. të prokurimit 616-25-6122-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Konsiderohet e tërhequr** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Selmans Network shpk" të datës 29.12.2025 kundër njoftimit të AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e mobilerisë urbane" me nr. të prokurimit 616-25-6122-2-1-1.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi si dhe **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj tutje me këtë procedurë të prokurimit.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Selmans Network shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 29.12.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit të AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja e mobilerisë urbane" me nr. të prokurimit 616-25-6122-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parastruesi me datë 30.12.2025 ka dërguar një njoftim sipas të cilit ka konfirmuar se është tërhequr nga kërkesa për rishqyrtim e cituar si më sipër.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin c) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 31.12.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.